4.4 Planifikimi dhe monitorimi i planit të punës për indikatorin “regjistrimi i pasurive” për Raportin “Lehtësira e të bërit Biznes 2019”.

Të dhënat krahasuese me DB 2019

	DB 2020	DB 2019
Renditja	98	98
Piket	63,4	62,08

Treguesit e transferimit të titullit të pronësisë për biznesin

	DB 2020	DB 2019	Europa dhe Azia Qendrore	Vendet e OECD
Nr. i procedurave	5	5	5,5	4,7
Afati kohor i regjistrimit (dite)	19	19	20,8	23,6
Kostoja (% e vlerës se pasurisë)	8,9	9,2	2,7	4,2
Indeksi i cilësisë së administrimit të tokës (0 – 30)	16,5	15,5	20,4	23,2

Indeksi i cilësisë së administrimit të tokës

Indeksi	Vlera	DB 2020	DB 2019
Indeksi i Besueshmërisë së Infrastrukturës	0 – 8	6	6
Indeksi i Transparencës së Informacionit	0 – 6	2,5	2,5
Indeksi i Mbulimit Gjeografik	0 – 8	0	0
Indeksi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve	0 – 8	8	7
Indeksi i Barazisë Gjinore	-2 - 0	0	0

4.5 FINANCAT, BURIMET NJERËZORE DHE SHËRBIMET

4.5.1 SITUATA FINANCIARE

Planifikimi buxhetor.

Në mbështetje të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.7/1, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021", ASHK ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, Faza I, për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 21 Drejtoritë e varësisë.

Në zbatim të ligjin Nr.109/2017 "Për buxhetin vitit 2019", Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë" nr. 2, datë 19.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kryer detajimi i fondeve buxhetore, detajimi i limiteve mujore (planit të arkës) për drejtoritë e varësisë të ASHK-s, të cilat u miratuan nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. E njëjta procedurë u realizua edhe për numrin e punonjësve, të miratuar për Institucionin. Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësisë së ASHK-s, filluan vitin e ri buxhetor me fonde dhe numër punonjësish të miratuar, në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore.

Në janar të vitit 2019, janë paraqitur të argumentuara në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe te Ekonomisë **kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme**, për drejtoritë e varësisë dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej **466 punonjësish**.

Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve publike buxhetore.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka bërë menaxhimin dhe monitorimin periodik të realizimit të shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësisë së ASHK-s. Në përmbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht, çdo 4-mujor, raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit.

Për vitin 2019, janë administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore sipas dy programeve të miratuara e konkretisht:

- Shpenzimet
- Investimet Publike

Shpenzimet nga buxheti i shtetit

Në mbështetje të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", në bazë të Urdhrit nr.84, datë 02.05.2019 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës" dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Njësitë shpenzuese të Institucionit tonë vazhduan veprimet me degët përkatëse të thesarit deri më 31.12.2019 ku kryen shpenzime për paga ,sigurime shoqërore dhe mallra e shërbime sipas buxhetit të disponueshem përkatës deri me 31.12.2019.

Nga buxheti i shtetit i miratuar me Ligjin e buxhetit 99/2018 dt.03.12.2018 u mbuluan shpenzimet për paga e sigurime shoqërore për 315 punonjës të organikës të detajuar për Ish drejtoritë e ALUIZNI-t , ku efekti financiar nga ndryshimi i pagave u kompensua nga kursimi i fondeve buxhetore të këtij viti si rezultat i vakancave në vendet e punës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore’ dhe të numrit të depozituar për çdo ish drejtori të ALUIZNI-t në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u mbuluan shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për 466 punonjës me kontratë të përkohshëm nga fondet buxhetore dhe të ardhurat që u krijuan nga procesi i legalizime.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore operative “Mallra dhe shërbime”, për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë e varësisë të ASHK-s është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtoritë	Planifikimi	Realizimi	%
1	Berat	1.800.000	1.573.250	87
2	Dibër	1.800.666	1.197.604	67
3	Durrës	2.800.000	1.297.499	34
4	Elbasan	2.800.000	2.791.729	99,7
5	Fier	3.704.011	3.607.350	97,4
6	Gjirokastrë	1.800.000	1.798.848	99,9
7	Kavajë	1.200.000	950.127	79,1
8	Krujë	1.200.000	1.102.931	91,9
9	Korçë	2.610.192	1.943.965	71,9
10	Kukës	1.800.000	1.800.000	100,0
11	Lezhë	3.000.000	2.028.061	67,6
12	Lushnje	1.200.000	838.690	69,9
13	Shkodër	3.000.000	2.678.343	89,2
14	Vlorë	6.154.687	5.693.049	92,5
15	Sarandë	3.074.448	2.535.175	82,5
16	Tiranë Veri	5.400.000	5.283.101	97,8
17	Tiranë Jug	3.000.000	2.680.087	89,3
18	Tiranë Rurale 2	1.400.000	1.292.252	89,5
19	Tiranë Rurale 1	5.400.000	4.796.311	88,8
20	Zonat Turistike	1.200.000	929.053	77,5
21	Kamëz-Vorë	4.100.000	3.093.587	75,5
22	D. Përgjithshme	23.556.662	22.213.880	94,3
	TOTALI	82.000.000	72.036.085	87,8

Shpenzimet operative faktike gjatë 12 mujorit të vitit 2019, janë realizuar në rreth 87.8% të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, në janar të vitit 2019, janë paraqitur të argumentuara në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme, për drejtoritë e varësisë dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej 466 punonjësish.

Drejtoritë e varësisë, për plotësimin e nevojave për paga e sigurime për punonjësit me kontratë të përkohshme si dhe shpenzime operative, përdorin edhe fonde nga të ardhurat që realizohen. Të ardhurat e përdorura për përballimin e këtyre shpenzimeve kornete kanë qënë 134.470.568 lekë, dhe me të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Drejtoritë	Për Paga+ Sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë	Për Mallra dhe shërbime
1	Berat	3.003.880	0
2	Dibër	1.164.782	0
3	Durrës	8.419.762	0
4	Elbasan	7.366.886	1.245.656
5	Fier	6.143.960	203.240
6	Gjirokastrë	1.998.512	95.034
7	Kavaje	2.992.645	725.779
8	Kruje	1.197.880	0
9	Korçe	4.541.484	710.192
10	Kukës	700.000	1.263.000
11	Lezhe	5.785.823	0
12	Lushnje	3.130.217	0
13	Shkodër	5.244.030	23.380
14	Vlore	10.712.481	920.558
15	Sarandë	6.355.491	1.020.937
16	Tirane Veri	8.076.938	1.760.378
17	Tirane Jug	12.688.613	1.305.894
18	Tirane Rurale 2	9.452.870	324.340
19	Tirane Rurale 1	9.358.965	389.087
20	Zonat Turistike	7.618.159	480.487
21	Kamez Vore	7.950.457	0
22	D. Përgjithshme	0	0
	TOTALI	123.899.335	10.467.962

Brenda totalit të shpenzimeve të përgjithshme (buxhet+ të ardhura), shpenzimet "Mallra dhe shërbime" zënë 12.69%, ndërsa në vetvete 10.86% e tyre janë përballuar nga të ardhurat e realizuara.

Sipas zërave përbërës të tyre, shpenzimet kornete janë realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Artikulli	Emërtimi	Buxheti 2019			Buxheti/Te Ardhura	
		Plan	Fakt	Në %	Fakt	
600	Shpenzime personeli Paga	431.940.500	428.498.107	99.2	103.236.989	531.735.096
601	Shpenzime personeli-sig.shoq.	71.997.800	70.057.587	97.4	20.662.346	90.719.933
602	Shpenzime operative	82.000.000	72.036.085	87.8	10.467.962	82.540.894
603-606	Të tjera shpenzime korrenti	1.161.700	410.265	35.3		410.265
	Shpenzime kornete	587.000.000	571.002.044	97.27	134.367.297	705.404.179

4.5.2 Investimet

Për vitin 2019, programi “Investimet publike me financim të brendshëm” është monitoruar në mënyrë të veçantë, dhe realizimi i tij është ndjekur me raportim mujor të veçantë dhe së bashku me atë të përformancës së shpenzimeve buxhetore, duke evidentuar edhe fazat e veçanta në të cilat ndodhet shpenzimi.

Realizimi i këtij programi për këtë vit është në masën 99.74%, më i detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emri i Institucionit	Buxheti 2019	Vlera Totale e Kontratës	Realizimi ne %
Drejtoria e Përgjithshme	32.680.000	32.593.805	99.74
TOTALI	32.680.000	32.593.805	99.74

Realizimi zë për zë i fondeve buxhetore është analizuar me njësitë shpenzuese përkatëse për të zbuluar arsyet e mosrealizimit. Në njësitë shpenzuese janë kryer procedurat e prokurimit sipas përcaktimeve të LPP. Sqarojmë se fondet e limituara për muajin dhjetor nuk mundën të prokurroheshin pasi për arsye të tërmetit u ndërpre ky proces.

4.5.3 Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimeve

Gjatë 12 mujorit të vitit 2019, Drejtoritë e ASHK-s kanë realizuar të ardhura nga procesi i legalizimit nga vlera e parcelës ndërtimore, tarifa e shërbimit dhe penalitetet. Të ardhurat e realizuara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	DREJTORIA	Vlera e Parcelës ndërtimore	Arkëtime nga tarifa e shërbimit	Arkëtime nga penalitete
1	Berat	5,224,447	1,744,000	363,082
2	Dibër	5,685,409	1,320,000	4,452
3	Durrës	115,868,065	2,166,000	2,517,888
4	Elbasan	75,786,899	4,584,000	4. 131,216

5	Fier	17,296,378	1,128,000	1,025,747
6	Gjirokastrë	17,011,672	904,000	
7	Korçë	6,785,764	1,196,000	3,011,255
8	Kukës	7,304,391	576,000	231,777
9	Lezhe	9,408,700	1,424,000	455,420
10	Lushnje	14,771,413	936,000	348,899
11	Shkodër	12,290,135	1,076,000	23,388
12	Sarandë	57,404,458	3,464,100	21,667,771
13	Vlorë	88,020,251	2,064,000	2,531,531
14	Tiranë Veri	133,042,561	1,416,000	369,512
15	Tiranë Rurale 2	14,070,398	1,853,198	3,887,006
16	Tiranë Rurale 1	13,812,675	3,640,000	11,240,344
17	Zona Turistike	136,611,012	5,562,782	1.421.048
18	Kamez-Vorë	99,532,373	1,892,662	2,146,465
19	Tirana jug	174,485,145	4,878,214	10,751,918
20	Krujë	2,361,061	779,378	1,016,059
21	Kavajë	7,735,657	1,416,000	743,921
	TOTALI	1,014,541,865	44,020,338	68,183,643

Vlen të theksohet se këto janë të dhëna të dërguara nga Drejtoritë e varësisë për Vitin 2019, janë të rakorduara me degët përkatëse të thesarit.

Gjatë vitit 2019 janë transferuar në fondin e kompensimit të pronarëve **722.973.641 lekë** nga të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndërtimore të objekteve pa leje.

Janë arkëtuar në total 1.126.745.846 lekë nga 1.150.000.000 lekë të parashikuar për tu arkëtuar.

Janë shpenzuar nga drejtoritë e varësisë për paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative 134.367.297 lekë, ju kthyen buxhetit 170.000.000 leke financimi paradhënie për këto paga dhe sigurime si dhe mbetën në buxhet të **ardhura të papërdorura në vlerë 99.404.909 lekë**.

Edhe për vitin 2019 është punuar në çdo drejtori për arritjen e objektivave të vendosura në PBA, punë e cila ka çuar në tejkalimin e tyre, ku **nga 1 miliard lekë** të caktuara në objektivat tona për arkëtimet nga vlera e parcelës ndërtimore **janë realizuar 1.014.541.865 lekë**, dhe nga **700.000.000 lekë** të caktuara në objektivat tona për tu derdhur në buxhet u arrit në shifrën **722.973.641 lekë**.

4.6 RAPORT EKONOMIKO-FINANCIAR I ASHK

Në zbatim të Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 «Për Kadastrën», Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 630 datë 25.09.2019 «Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës»; në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe rritjes së transparencës në përdorimin e


fondeve publike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka ushtruar veprimtarinë ekonomiko – financiare gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2019 në drejtim të regjistrimit të pasurive të paluajtshme , si më poshtë:

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga shërbimet e kryera në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për periudhën Janar – Dhjetor 2019 janë 1,683,249 mijë lekë. Ato janë realizuar në masën 95 % (ose 89,791 mije leke me pak) krahasuar me të ardhurat e planifikuara për këtë periudhë. Në mënyrë tabelare dhe grafike më poshtë pasqyrohet krahasimi i planit me faktin e të ardhurave:

Në 000/lekë

	Të ardhurat e ASHK	
Periudha	Plani Janar - Dhjetor 2019	Fakti Janar – Dhjetor 2019
TOTALI	1,683,249	1,593,458



Te ardhurat Janar – Dhjetor 2019 janë realizuar 97.1 % (ose 46,358 mije leke me pak) krahasuar me të ardhurat e realizuara ne periudhën Janar-Dhjetor 2018. Në mënyrë tabelare këto të ardhura janë paraqitur si më poshtë.

Në

000/lekë

	Të ardhurat e ASHK	
Periudha	Janar - Dhjetor 2018 (Fakti)	Janar - Dhjetor 2019 (Fakti)
TOTALI	1,640,092	1,593,458

Ne realizimin e te ardhurave peshën me te madhe e zënë te ardhurat nga shërbimet e mëposhtme:

- 1) Lëshim certifikate pronësisë (15 % te totalit të të ardhurave)
- 2) Lëshim kopje kartele të pasurisë (15% te totalit të të ardhurave)
- 3) Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale (13 % te totalit të të ardhurave)

Një ndikim në realizimin e totalit të të ardhurave për vitin 2019 ka patur dhe futja e shërbimit Fast Track për 9 prej 51 shërbimeve në Drejtoritë Vendore të ASHK. Shërbimi fast track ka të bëjë me dhënien e shërbimit në një afat kohor prej 24 orësh kundrejt një tarife më të lartë.

Në të ardhurat nga shërbimet **nuk përfshihen** të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e shtetit si agjent tatimor për:

- Tatimin mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë (15%)


Të ardhurat nga Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë

Në zbatim të Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ardhurat që ASHK vjel si agjent tatimor për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, derdhen:

- a) 97 % për buxhetin e Bashkisë apo Njësisë Administrative, në territorin e së cilës ndodhet pasuria
- b) 3% në buxhetin përkatës të Drejtorive Vendore të ASHK-së, në llogaritë respektive jobuxhetore.

Të ardhurat totale nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për periudhën Janar - Dhjetor 2019 janë 19,020 mijë lekë.

Drejtoritë Vendore që kanë pasur më shumë kalime pronësie të pasurive që kanë qenë në pronësi të subjekteve tregtare janë: Tirana Veri, Tirana Jug, Durrës, Kamëz-Vorë, Vlorë, Fier, Shkodër, Sarandë, Kavajë, Korçë, Lushnje etj. Paraqitja grafike është si më poshtë:




Numri i shërbimeve

Njësia aktuale e matjes së nivelit të punës në sistemin e regjistrimit është “shërbimi”. Në këtë kontekst një “shërbim” është çdo transaksion që ndodh në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kur kërkohet një kopje e kartelës, një kërkesë për lëshimin e

certifikatës, një kërkesë për regjistrimin e një dokumenti apo kërkesa për shërbime të tjera, ndër 51 shërbimet e ndryshme që ofron ASHK

Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 numri i shërbimeve është 947,518 dhe është realizuar 97.6% (ose 23,589 shërbime me pak) krahasuar me planin. Në mënyrë tabelare dhe grafike paraqitet si më poshtë:

Numri i shërbimeve të ofruara në ASHK, Janar-Dhjetor 2019		
	Plan	Fakt
TOTALI	971,107	947,518



Numri i shërbimeve të aplikuar në ASHK për periudhën Janar - Dhjetor 2019 është 946,901 shërbime, 96.2 % ose 37,104 shërbime më pak se numri i shërbimeve të aplikuar në ASHK për periudhën Janar – Dhjetor 2018. Në mënyrë tabelare këto të dhëna paraqiten si më poshtë:

Numri i shërbimeve të ofruara në , Janar-Dhjetor 2018-2019		
	Janar-Dhjetor 2018(Fakti)	Janar – Dhjetor 2019(Fakti)
TOTALI	984,005	946,901

Shërbimet të cilat zënë peshën specifike më të madhe janë:

Lëshim certifikate pronësie 16%

Lëshim fragment harte kadastrale 21%

Lëshim kopje kartele 24 %

-Mosrealizimi i shërbimeve për vitin 2019 krahasuar me planin ka ardhur si pasojë e forcës madhore të tërmetit ku shumë nga objektet ku zhvillojnë veprimtarinë e Drejtorive Vendore ,siç ishin 5 Drejtoritë Vendore të Tiranës, Durrësit (që zënë peshën specifike më të madhe në realizimin e të ardhurave dhe shërbimeve), të Laçit ,të Lezhës, të cilat u dëmtuan nga tërmeti dhe u bënë të pabanueshme dhe për pasojë nuk kryen shërbime gjatë muajit Dhjetor.

Persa i përket Pagave, Sigurimeve dhe fondit të veçantë të ASHK-se për periudhën Maj-Dhjetor 2019, i jemi referuar strukturës së ASHK-se të miratuar me Urdhrin nr. 84 date 02.05.2019 “ Për miratimin e strukturës dhe të organikes të agjencisë Shtetërore të Kadastrës si dhe VKM-se nr. 245 date 24.04.2019 “ Për miratimin e Strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi page të nëpunësve dhe punonjësve administrative në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Si dhe Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 4, datë 16.05.2019“Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës” ku është miratuar:

- *Një numër prej 382 punonjësish me kontratë të përkohshme për vijimësinë e Projektit të Përmirësim Përditësimit, Regjistrimit Fillestar dhe dixhitalizimit të të dhënave të pasurive të paluajtshme, për vitin 2019.*
- *Një numër prej 175 punonjësish me kontratë të përkohshme në pozicionin specialist, për përmirësimin e shërbimit në drejtim të regjistrimit të ndërtimeve informale, realizimit të kërkesave për informacion në kuadër të vetingut dhe bashkëqeverisjes si dhe regjistrimit fillestar të AMTP-ve për vitin 2019.*
- *Një numër prej 466 punonjësish me kontrate të përkohshme i miratuar sipas përcaktimeve të VKM nr. 16 date 16.01.2019 “ Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qëndrore “ (lidhja 1, Gr.14, ALUIZNI).*

Punonjësit me kontratë të përkohshme, përfitojnë të njëjtin trajtim financiar me punonjësit organik, për pozicionin, për të cilin ai kontraktohet dhe merret në punë, në përputhje me kriteret e parashikuara për atë vend pune.

Në mënyrë të përmbledhur fondi që nevojitet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore paraqitet si me poshtë:

SHPENZIMET

1. Shpenzimet e personelit për çdo njësi shpenzuese janë ekzekutuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 630 datë 25.09.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Urdhrin nr. 84 date 02.05.2019 “ Për miratimin e strukturës dhe të organikes të agjencisë Shtetërore të Kadastrës si dhe VKM-se nr. 245 date 24.04.2019 “ Për miratimin e Strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi page të nëpunësve dhe punonjësve administrative në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës(Për punonjësit në organikë dhe ato me kontratë të Përkohshme).

Në mënyrë të detajuar pasqyrohen si më poshtë

Shpenzimet faktike të personelit për periudhën Janar - Dhjetor 2019 janë:

Në 000/ lekë

Periudha	Lloji i shpenzimit	Plani	Shpenzimet Faktike
Janar – Dhjetor 2019	PAGA	710,792	684,489
	SIGURIMET SHOQËRORE	122,160	108,255
	Fond I Veçante	31,240	4,179

	TOTALI	864,192	796,923
	Paga-sigurime te perealizuara		67,269

2. Shpenzimet operative : Janë shpërndarë për 24 Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës duke u mbështetur në realizimin faktik për periudhën Janar-Prill 2019 si dhe eksperiencën e shpenzimeve të ekzekutuara në vitet paraardhëse për energji, ujë, telefon, shërbim postar, shpenzime udhëtimi, qera, komisione bankare etj si dhe kërkesave të Drejtorive Vendore për periudhën Maj-Dhjetor 2019.

Në mënyrë të përmbledhur sipas nënartikujve, krahasimi i faktit me planin e shpenzimeve operative për periudhën Janar - Dhjetor 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

ANALIZA E SHPENZIMEVE JANAR- DHJETOR 2019 KRAHASUAR ME PLANIN

Ne
000/leke

Artikulli	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Viti 2019(PLANI)	Fakti Janar- Dhjetor 2019	Realizimi ne përqindje
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	56,508	26,478	47%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	8,550	3,299	39%
6022	Shërbime nga të treta	168,889	120,734	71%
6023	Shpenzime transporti	7,501	4,091	55%
6024	Shpenzime udhëtimi	15,839	11,730	74%
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	16,969	5,510	32%
6026	Shpenzime për qiramarrje	3,600	8,249	229%
6027	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	183,321	41,002	22%
6029	Shpenzime të tjera operative	14,841	7,725	52%
	Totali	476017	228,817	48%
	Shpenzime të perealizuara		247,200	

Ne realizimin faktik të shpenzimeve operative në masën 48 % një ndikim të rëndësishëm ka pasur dhe moslikujtimi i gjyqit të arbitrazhit i cili është planifikuar në një vlerë të konsiderueshme prej 150 milionë lekësh i cili në totalin e shpenzimeve zë një peshë specifike prej 31.5 %, dhe jemi munduar të disiplinojmë dhe të kursejmë këto shpenzime.

3. Investimet: Investimet për periudhën Janar – Dhjetor 2019 janë realizuar krahasuar me planin si më poshtë:

INVESTIMET JANAR-DHJETOR 2019

Artikulli	Shpenzime Kapitale	Në 000/lekë	Në 000/lekë
		Plani Janar-Dhjetor 2019	Realizimi Janar-Dhjetor 2019
231	Rikonstrukcion I Drejtorive dhe Zyrave Vendore te ASHK	20,577	12,491
231	Pajisje për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK	89,281	1,520
231	Orendi për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK	2,650	1,326
231	Kondicioner për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK	3,408	649
231	Sistem I Mbrojtjes Kundra Zjarrit (MKZ) për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK	3,255	0
231	Sistem sigurie kamera për Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK	3,250	300
231	Sistem check-in hyrje dalje për Drejtori Vendore te Tiranës	300	0
231	Dhome Serverash	65,000	0
	Shuma 231	187,721	16,285
230	Sistemi I menaxhimit te proceseve nderdepartamentale	60,000	0
230	Sistemi I menaxhimit te burimeve njerëzore	30,000	0
230	Platforme BI Analizim dhe Raportim	80,000	0
230	ITSM - IT Service Management System	10,000	0
230	Sistem Qendror Antivirusi	15,000	0
230	Incidentet Kibernetike	74,000	0
230	Permirësimi I Arkives Dixhitale (Kontrata nr.1025 datë 26.02.2019)	109,482	6,029
230	Programe dhe Licenca	51,364	0
230	Përmirësimet e disa funksionaliteteve te ofruara nga sistemi ALBSReP si dhe te shtimit te një moduli për te mundësuar pagesat on-line (Kontrata nr. 4519 datë 11.09.2018)	39,513	19,035
230	Projekti i përmirësim / Përditësimit dhe regjistrimit fillestar	384,730	222,636
	Lidhje printim karteles	400	228

230	Mirëmbajtja për projektin "Përshtatja e Backend-it për lidhjen më platformën qeveritare të ndërveprimit në lidhje me 51 shërbimet e ZRPP sipas marrëveshjes me AKSH-in"	948	0
230	Mirëmbajtja për Projektin "Përmirësimi i NID-eve"	480	0
230	Mirëmbajtja për projektin "Ndërtimi i Sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në ZRPP"	2,880	2,400
	Shuma 230	908,796	250,329
	Investime Gjithsej (230+231)	1,096,517	266,613
	Te papërdorura nga investimet(230+231)	829,903.63	

Në mënyrë të përmbledhur, të ardhurat dhe shpenzimet e ASHK për periudhën Janar - Dhjetor 2019, paraqiten si më poshtë:

Të ardhurat dhe shpenzimet faktike për ASHK për periudhën Janar - Dhjetor 2019

Nr.	EMËRTIMI	Plani në 000/Lekë	Fakti në Lekë	Realizimi në %
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	3,220,904	3,131,388	
	Të ardhura nga Tarifat e Shërbimeve	1,683,249	1,593,734	95%
	Te ardhura te trashëguara	1,432,955	1,432,955	
	Fond Rezerve I trashëguar	104,700	104,700	
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	3,220,904	1,292,352	40%
1	Shpenzime Korrente nga të cilat	1,340,209	1,025,739	77%
1	Shpenzime personeli	864,192	796,922	92%
	Paga sipas strukturës organike të miratuar+punonjes me kontrate	710,792	684,489	96%
	Kontributi për Sigurime Shoqërore Punonjës organike+punonj.me kontrate	122,160	108,255	89%
	Fondi i veçantë	31,240	4,179	13%
2	Shpenzime Operative	476,017	228,817	48%
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	326,017	228,817	70%
	Shp për detyrime që lindin nga neni 67, I Ligjit 33/2012 (Gjyqi I Arbitrazhit)	150,000	0	0%
3	Shpenzime Kapitale nga të cilat	1,096,517	266,613	24%
	Investime kapitale të brendshme të trupëzuara	187,721	16,285	9%
	Investime kapitale të brendshme të patrupëzuara	523,666	27,692	5%
	Projekti përmirësimi përditësimit	385,130	222,636	58%
4	Fond Rezerve	104,700	0	0%

5	Fonde te parashikuar për tu trashëguar ne vitin e ardhshëm	679,478	0	0%
	TË ARDHURA(-)SHPENZIME	0	1,839,036	
	Fond reserve për tu trashëguar	0	104,700	
	VLERA QE DO TE TRASHEGOHET NGA VITI 2019		1,734,336	

Diferenca të ardhura – shpenzime faktike rezulton në vlerën **1,839,036** mijë lekë, qe do te thotë se kemi mosrealizim të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara.

Fondi rezervë

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 218 datë 20.03.2013 “Për miratimin e kufijve dhe kriterëve të përdorimit të fondit rezervë të ish Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për vitin 2019 nuk u planifikua Fond rezerve, meqenëse Fondi rezervë i krijuar për vitet 2013, 2014 dhe 2015 i cili kap vlerën ne total 104.700 mijë lekë nuk është përdorur. Ne zbatim te ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ky fond rezerve i akumuluar trashëgohet dhe mund të përdoret në rast nevojë për mbulimin e dëmshpërblimeve.

4.7 INFRASTRUKTURA DHE AMBIENTET

Viti 2019 ka qënë një vit shumë intensiv për nga ngarkesa e punës dhe shumë i vështirë për nga problematikat e hasura të cilat kanë lidhje me riorganizimin e institucionit si dhe vështirësitë e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore.

Vështirësia kryesore ka qënë ndryshimi e decentralizimi i planifikimit e realizimit të nevojave në mallra e shërbime nga drejtoritë vendore.

Sipërfaqet e zyrave dhe pronësia e tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Drejtoria	Sipërfaqja	Gjendja e hapësirave
1	Drejtoria e Përgjithshme e ASHK	2500	Të pamjaftueshme dhe kane nevojë për rikonstruksion
2	Drejtoria e ASHK Tiranë Veri	681,6	
3	Drejtoria e ASHK Tiranë Jug	623,6	
4	Drejtoria e ASHK Tiranë Rurale 1	548,6	
5	Drejtoria e ASHK Tiranë Rurale 2	558,6	
6	Drejtoria e ASHK Kamëz – Vorë	548,6	
	Zyra Vendore Kamez		
7	Drejtoria e ASHK Zonat e Stimuluara	294	Ne gjendje te mire
8	Drejtoria e ASHK Durrës	830	Ka mungese për hapësira. Arkiva vijon ne godinën e Bashkisë. Ambientet e ish ZVRPP ne gjendje te mire
	Zyra Vendore Shijak		

9	Drejtoria e ASHK Elbasan	1460	Gjendja përgjithësisht e mire. Ka nevojë për investim vetëm në katin e parë
	Zyra Vendore Librazhd	285	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Gramsh	160	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Peqin	95,8	Hapësira tejet të limituara
10	Drejtoria e ASHK Vlorë	795/1273 truall	Godinë e sapo marrë në përgjegjësi administrimi. Kërkon rikonstrukcion të plote
	Zyra Vendore Himare		Një ambient pranë Bashkisë
11	Drejtoria e ASHK Fier		Hapësira të mjaftueshme.
	Zyra Vendore Mallakastër	138,73	
12	Drejtoria e ASHK Shkodër		Hapësira tejet të limituara, megjithëse ka edhe ambiente me qira
	Zyra Vendore Malësi e Madhe	224	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Puke	120	Ne gjendje të mire
13	Drejtoria e ASHK Korçë		Godinë e sapo marrë në përgjegjësi administrimi. Kërkon rikonstrukcion.
	Zyra Vendore Kolonje	312,5	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Devoll	140	Ne gjendje të mire
14	Drejtoria e ASHK Lezhë	740	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Kurbin		
	Zyra Vendore Mirdite	231	Ne gjendje të mire
15	Drejtoria e ASHK Berat		Vijon aktivitetin në ambiente të ndara
	Zyra Vendore Skrapar	190	Ne gjendje të mire
16	Drejtoria e ASHK Kavajë	413,9	Ne gjendje të mire
17	Drejtoria e ASHK Gjirokastrë		Vijon aktivitetin në ambiente të ndara
	Zyra Vendore Përmet	203	Ne gjendje të mire
18	Drejtoria e ASHK Krujë		116/620
19	Drejtoria e ASHK Lushnje		Kërkon rikonstrukcion, përshtatje. Akoma nuk ka kaluar në përgjegjësi administrimi
	Zyra Vendore Divjake		Nuk ka filluar të funksionojë
20	Drejtoria e ASHK Pogradec	286	Ne gjendje të mire
21	Drejtoria e ASHK Sarandë	306	Vijon aktivitetin në ambiente të ndara. Ambientet e ish ZVRPP në gjendje të mire
	Zyra Vendore Delvine		Është duke u krijuar
22	Drejtoria e ASHK Dibër	360	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Mat	217	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Bulqize	235	Ne gjendje të mire
23	Drejtoria e ASHK Kukës	270,18	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Tropoje	170	Ne gjendje të mire
	Zyra Vendore Has	43,5	Ne gjendje të mire
24	Drejtoria e ASHK Kuçovë		Ne gjendje të mire
25	Drejtoria e ASHK Tepelenë	312	Ne gjendje të mire

Përgjithësisht në drejtoritë e ASHK-së, gjendja e ambienteve të punës paraqitet jo e mire, kjo si përse i përket hapësirave në dispozicion por edhe gjendjes teknike të

tyre. Shumë prej tyre vijojnë punën në dy godina të ndryshme, gjë e cila sjell vështirësi në drejtim të koordinimit të punës dhe kontrollit.

Në krahasim me një vit më parë për Drejtoritë Vendore Tiranë mund të themi se situata është përkeqësuar si pasojë e dëmtimit të godinës nga tërmeti i 26 Nëntorit. Për sistemimin e punonjësve dhe inventarit u morën masa të menjëhershme duke transferuar DVASHK-së Tiranë në ambiente me qira, në hapësira të përshtatshme për funksionimin e aktivitetit të tyre. Ndërkohë po vijon puna për sistemimin arkivave për dokumentacionin arkivor që disponojnë deri në 31.12.2019.

Gjatë vitit 2019, janë transferuar në përgjegjësi administrimi të ASHK-së për tu përdorur për drejtoritë vendore objektet e ish Drejtorisë së Arkivave Korçe dhe Godina e Shtëpisë së Ushtarakëve Vlorë. Të dyja këto objekte kanë nevojë për rikonstruksion për tu kthyer në ambiente të përdorshme pune.

Përsa i përket nevojave për automjete, ajo paraqitet e njëjtë duke qenë se nuk ka patur shtesë në numrin e automjeteve dhe nuk ka qenë e mundur planifikimi në fonde për investime për to. Megjithatë për mjetet në dispozicion janë ndjekur me korrektesë kryerja e shërbimeve profilaktike për ti mbajtur ato në efikasitet.

Përsa i përket plotësimit me mallra e shërbime të zakonshme, janë orientuar drejtoritë vendore të planifikojnë e kryejnë procedura të pavarura duke mos penguar punën e zgjatur afatet e plotësimit të tyre.

4.8 PROKURIMET PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, drejtoritë e ASHK-s kanë kryer procedura prokurimi për mallra e shërbime që i janë nevojitur për kryerjen e aktivitetit.

Përgjatë vitit 2019 nga Drejtoria e Përgjithshme dhe 24 drejtoritë vendore të ASHK-s janë zhvilluar 445 procedura prokurimi.

Krijimi i Institucionit të ri u shoqërua me ndryshime në nevojat për shërbime, gjë që u reflektua në unifikimin e regjistrave të parashikimit të prokurimeve publike të drejtorive, si dhe zërave në to. Përshtatja e ambienteve të zyrave apo nevoja për të qenë në ambiente të përbashkëta pune u shoqërua me shtimin e zërave për shërbime të paparashikuara (si p.sh. transport), por sidoqoftë situatat e krijuara u përballuan në mbështetje të ligjeve dhe rregullave të Prokurimit publik në fuqi.

Pasojat e tërmetit të datës 26.11.2019 u shoqëruan gjithashtu me lindjen e nevojave të paparashikuara për punë dhe shërbime, në mënyrë që të garantohej vazhdimësia normale e punës.

Fondi Investimeve me vlerë 32,680,000 lekë, parashikuar nga ish-ALUIZNI, për blerjen e pajisjeve elektronike (kompjutera, printera, skanera, fotokopje), procedurë e zhvilluar nga AKSHI, është ezauruar në masën 100%.

Vlera e shpenzimeve të kryera prej disa drejtorive vendore për rikonstruksionin e godinave të tyre apo të zyrave në varësi ka zënë rreth 26.8% të zërit të investimeve. Në tabelën më poshtë paraqiten të detajuara sipas drejtorive shpenzimet për rikonstruksion.

Nr.	Shpenzime për Rikonstruksione (në lekë me TVSH)	
1	Elbasan	994,622
2	Kamëz-Vorë	97,580
3	Shkodër	276,000
4	Fier	1,350,648
5	Korçë	377,880
6	Lezhë	673,520
7	Berat	7,072,556
8	Gjirokastër	129,960
9	Kukës	2,146,800
TOTAL		13,119,566

4.9 BURIMET NJERËZORE, REKRUTIMET DHE ECURITË DISIPLINORE.

Ligji 111/2018 “Për Kadastrën”, shënon krijimin e institucionit të ri Agjencia Shtetërore e Kadastrën si bashkim i tre institucioneve që vepronin në fushën e pronësisë dhe konkretisht , të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, dhe Agjencisë së Inventarizimit, dhe Transferimit të Pronave Publike. Përpara bashkimit të institucioneve kryesore të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, dhe Agjencia e Inventarizimit, dhe Transferimit të Pronave Publike, funksiononin si institucione më vete.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përbëhej në total nga 688 punonjës (të shpërndarë në zyrën qendrore dhe zyrat vendore) në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.33, datë 2.4.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrës e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ndryshuar me Urdhrin nr.196, datë 4.8.2014, dhe Urdhrin nr.123, datë 31.7.2018. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e kryente veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr.33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar.

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale përbëhej në total nga 315 punonjës, të shpërndarë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë vendore) në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.58, datë 5.4.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, dhe e ushtronte veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.


Agjencia e Inventarizimit, dhe Transferimit të Pronave Publike përbëhej në total nga 13 punonjës, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.81, datë 21.2.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Inventarizimit, dhe Transferimit të Pronave Publike”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, funksionet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, dhe Agjencisë së Inventarizimit, dhe Transferimit të Pronave Publike, janë përthithur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, struktura dhe organika e së cilës është miratuar me Urdhrin e

Kryeministrit nr.84, datë 2.5.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Shtetërore e Kadastrës, me një numër total punonjësish prej 993 punonjës (158 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme, dhe 835 punonjës pranë drejtorive dhe zyrave vendore).

Për vitin 2019 në respektim të dispozitave të Kodit të Punës, për punonjësit e strukturës dhe ata me kontratë të përkohshme, janë dhënë gjithsej masa disiplinore, nga të cilat, 9 “Largim nga puna”, 6 “Ulje në detyrë”, 1 “Pezullim i përkohshëm”, 40 “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 87 “Vërejtje me shkrim”, 73 “Vërejtje”, dhe 78 “Tërheqje vëmendje”, 13 “Heqje e ditës së punës”.

MASA DISIPLINORE 2019



Ligji 111/2018 “Për Kadastrën”, Neni 11 “Marrëdhëniet e punës, kriteret, statusi dhe rekrutimi i punonjësve” në pikën 3 të tij parashikon një risi në lidhje me rekrutimin e burimeve njerëzore përkundër sa parashikonte legjislacioni përkatës mbi bazën e të cilit vepronin institucionet që u përfshinë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ku parashikon që kandidatët për t’u punësuar pranë ASHK-së i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

Në respektim të kësaj dispozite, duke marrë parasysh që ka një vakum aktesh nënligjore që rregullojnë këto aspekte të punësimit që lidhen me rekrutimin, etj., për institucionet ku marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës është e nevojshme të miratohen akte të brendshme ku të përcaktohen procedurat dhe modalitetet e nevojshme për tu respektuar në vijimësi. Aktualisht në procedurat e shpallura për plotësimin e vendeve vakante është operuar me miratimin rast pas rasti të procedurave të detyrueshme për zbatim.

Plotësimi i vendeve vakante në një institucion ku për periudhën korrik - dhjetor 2019 janë larguar gjithsej 85 punonjës (pa përfshirë largimet për efekt të ristrukturimit numri mesatar), pra më një mesatare mujore largimi prej 14 punonjësi, në muaj, është një sfidë reale për tu adresuar duke patur në vëmendje të veçantë faktin që cilësia e burimeve njerëzore ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni i ASHK ku, pozicionimi i personelit është shumë i rëndësishëm pasi punonjës të caktuar mbulojnë detyra kyçe e zëvendësimi i tyre

nuk është i lehtë dhe për më tepër kërkon një kosto shtesë edhe në trajnimin e punonjësve të rinj.

Duke vlerësuar sa më sipër, gjatë vitit 2019 i është dhënë përparësi rritjes së nivelit profesional të punonjësve, dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre. Një rëndësi e veçantë i është dhënë zhvillimit të trajnimeve të brendshme me karakter të posaçëm, që lidhen me kryerjen e detyrave të veçanta të punonjësve apo sektorëve të ndryshëm të drejtorive të ASHK-së. Gjithashtu punonjësit e ASHK-së kanë marrë pjesë edhe në trajnime të zhvilluara nga institucione të tjera shtetërore, me qëllim përfitimin e njohurive me të thelluara në kuadër të mbarëvajtjes së punës në institucion, si dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndërinstytucionale. Më kryesorët prej këtyre trajnimeve, po i rendisim më poshtë:

- Trajnim mbi sistemin e qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), në datë 24.12.2019. Në këtë trajnim kanë marr pjesë specialist IT nga drejtoria e përgjithshme dhe drejtoritë vendore, gjithsej 45 punonjës.
- Trajnim nga AZHT-ja (Agjencia e Zhvillimit të Territorit) herë pas here përgjatë vitit për drejtorët e drejtorive vendore dhe punonjësit përgjegjës për sistemin e-*leje*.
- Seminari trajnues për punonjësit e sekretari-arkivave, për pranimin, evidentimin, administrimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës së ruajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, nga data 18.11.2019 deri më 22.11.2019. Në total janë trajnuar 40 punonjës të arkivë-protokollit të drejtorive dhe zyrave vendore të ASHK-së.

Trajnimi i punonjësve gjatë gjysmës së dytë të vitit që kaloi ishte jo vetëm një domosdoshmëri në aspektin e përshtatjes dhe ndërthurjes së strukturave të tre institucioneve por edhe një prioritet i cili do të vazhdojë të mbetet i tillë edhe gjatë vitit në vijim.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës së drejtorisë së burimeve njerëzore në bashkëpunim edhe me strukturat përkatëse, lidhet me miratimin e akteve të brendshme që lidhen me aspektin organizativ të punës së institucionit.

Janë miratuar 2 (dy) rregullore të brendshme që rregullojnë aspekte specifike në lidhje me menaxhimin e burimeve Njerëzore, si vijon:

- Me Vendimin Nr. 11, datë 30.09.2019 të Këshillit Drejtues të ASHK është miratuar Kodi i Etikës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Me Urdhrin nr. 890, datë 28.01.2020 është miratuar Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”.

Aktualisht është në proces puna për miratimin e rregullores së brendshme një akt shumë i rëndësishëm ky, i planifikuar të mbyllet brenda gjysmës së parë të vitit 2020.

ECURIA E VEPRIMTARISË SË AUDITIT TË BRENDSHËM

- Analiza e programeve të Auditit të Brendshëm për periudhën raportuese.

Për vitin 2019 janë realizuar angazhime të Auditimit të Brendshëm në 5 subjekte, nga 6 të programuara në programin vjetor të ndryshuar, si dhe me kërkesë të Titullarit gjatë vitit 2019, janë kryer angazhime auditimi tematike në 5 subjekte.

- Analiza e misioneve të AB.

Realizimi i misioneve të auditimit është mbështetur në programin vjetor 2019, të ndryshuar, si pjesë e programit strategjik 2019-2021.

Në realizimin e angazhimeve të auditimit është punuar me një grup auditimi të përbërë nga tre auditues për shkak dhe të periudhës së tranzicionit të institucionit (Krijimi i Kadastrës nga bashkimi i ZQRPPsë me ALUIZNI-n).

Para kryerjes së auditimit subjektet janë lajmëruar për misionet e auditimit si dhe për takimin sipas axhendës, takime këto të fiksuara më parë.

Gjate tërë periudhës audituese është bashkëpunuar me stafin e subjekteve dhe në përfundim të praktikës audituese në terren është marrë kontakt me menaxhimin e subjektit për të trajtuar problematikat dhe gjetjet nëpërmjet takimit përmbyllës.

Në përgatitjen dhe plotësimin e dosjes audituese janë zbatuar për çdo subjekt hapat e auditimit, nëpërmjet raporteve paraprake, raportet përfundimtare, plan veprimeve dhe memo për Titullarin.

- Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në realizimin e planit vjetor 2019, të ndryshuar, risku është vlerësuar jo vetëm sipas fushave të sistemeve përkatëse, por dhe si subjekte, pra DVASHK-të që kryejnë transaksione në një volum të madh, që lëvizja e punonjësve është e shpeshtë, dhe risku është i lartë, ndërsa DVASHK-të me volum pune dhe personel të vogël dhe risku është i mesëm ose i ulët, duke ndërtuar mbi këtë bazë kampionin për testet e hartuara gjatë auditimit.

Në subjektet e audituara programi i auditimit u përqendrua në sistemin e përputhshmërisë dhe të performancës si sisteme me risk të lartë.

Gjatë auditimeve u planifikua si fusha me risk të lartë, llogaritja dhe arkëtimi i tatimit të kalimit të së drejtës së pronësisë të paluajtshme, zbatimi i tarifave, tejkalimi i afateve të shërbimeve, zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi, mos kryerja korekte e hapave në sistem, mos dorëzimi i dokumentuar i inventarit tekniko ligjor, mungesa në ndonjë

subjekt e administrimit në arshivë të vulës numëratore, etj.

Ndryshimet e shpeshta në personel përcaktuan dhe korrigjime në planifikimin e riskut, për shkak të ndryshimit të tij, ku fusha si llogaritja e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë nga fusha me risk të mesëm e të ulët gjatë një viti më parë, për vitin 2019 kaluan në fusha me risk të lartë, pavarësisht nga gjetjet në kampionet e marrë.

Risku i personelit me gjithë masat e marra për uljen e tij nëpërmjet trajnimeve me punonjësit e rinj në drejtim të aftësisë të tyre tekniko profesional si dhe seminareve trajnues për zbatimin e udhëzimit të tatimit dhe raportimit të pasqyrave financiare etj, përsëri ky risk paraqitet aktiv në administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor, kryerjen e hapave në sistem, llogaritjen e tatimit dhe zbatimin e afateve të shërbimeve.